



VENDIM
Nr. 77 Datë 15.10.2010

PËR
MOS MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË KODIN E MATJES

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, neneve 1 dhe 2 të Ligjit nr, 9997, datë 22.09.2008 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 26 pika 2 te Rregullave te Praktikës dhe Procedutave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.10.2010, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e Komisionit të Rishikimit të Kodit të Matjes, për disa ndryshime në Kodin e Matjes,

Konstatoi se:

- Në vitin 2008, me Ligjin nr. 9997, datë 22.09.2008 u shfuqizua tërësisht neni 46/1 si dhe ajo pjesë e nenit 46 pikë 2/c e cila i jepte të drejtë furnizuesit, pra Cez Shpërndarjes të vendoste masa administrative në përputhje me nenin 46/1.
- Në këto kushte që nga Shtatori 2008, furnizuesit ju hoq me ligj e drejta për të zbatuar masa administrative ndaj dëmit të shkaktuar nga marrja e paligjshme e energjisë elektrike dhe nga ana tjetër e drejta për të nxjerrë rregulla apo vlerësime çdëmtimi nuk ju delegua ndonjë institucioni tjetër shtetëror.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve.

Vendosi :

- 1- Mos miratimin e ndryshimeve ne piken III. 7 te Kodit te Matjes te miratuar me Vendimin nr. 101, date 26.08.2008.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimi të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit te njoftoje Cez Shpërndarjen per kete vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Bujar NEPRAVISHTA

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta” Nr.10
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al